

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6142  
E hënë, 19 tetor 2020  
çmimi 0.40 €

Avokati i Popullit:  
Institucionet të jenë  
të kujdesshme, s'do të  
ketë tolerancë aty ku  
shkelet ligji | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", BILALL SHERIFI | FAQE 4-5

## LAJÇAKU TË QËNDROJË EDHE NË DEKLARIMET PUBLIKE BRENDË ASAJ QË KËRKON NË TAKIME

Sekretari i përgjithshëm i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka bërë me dije se emisari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, duhet të qëndrojë edhe në deklaratimet publike brenda asaj që kërkon në takime. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se në takim me liderin e Nismës Socialdemokrate, përfaqësuesi i BE-së nuk e ka përmendur çështjen e ndryshimit të Kushtetutës së Kosovës për asociacionin e komunave me shumicë serbe. Sipas Sherifit, Lajçaku në takim ka thënë se asociacioni duhet të themelohet mbi bazën e marrëveshjes së vitit 2013 dhe mbi bazën e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë çështje



## HOTI KËRKON KUJDES MAKSIMAL PAS RITJES SË RASTEVE ME COVID-19



Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se institucionet po përgatiten që t'i përgjigjen rritjes së numrit të rasteve të reja me Covid-19, duke iu bërë thirrje qytetarëve për kujdes maksimal. Hoti ka thënë se pas rritjes së rasteve të reja me Covid-19, institucionet kanë bërë gati veprimet e nevojshme, për ta shmangur, siç u shpreh ai, një "mbyllje totale". Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit një pacient i infektuar me Covid ka vdekur dhe janë regjistruar edhe 137 raste të reja me këtë virus | FAQE 3

BEKIM JASHARI  
KËRKON TË  
NDRYSHOHET  
KUSHTETUTA  
PËR T'UA HEQUR  
SERBËVE VOTIMIN  
E DYFISHTË | FAQE 7



### OPINION

MUZGU I NGJASHMËRIVE  
HISTORIKE | F. 11

Fehmi AJVAZI



### AKTUALE

HYRJA ME VETURA NË QENDËR  
TË PRISHTINËS DO TË BËHET ME  
PAGESË | F. 10

PKD-ja: MUNGESA E KOLEKTORIT  
TË UJËRAVE TË ZEZA NË LAGJEN  
"KALABRIA" RREZIKON  
SHËNDETIN E QYTETARËVE | F. 7



### EKONOMI

KOSOVA AKUZON SERBINË PËR  
SHKELJEN E CEFTA-s | F. 9

OSMANI: SHTETI KA  
MBI GJYSMË MILIARDI EURO  
BORXHE NDAJ BIZNESEVE  
DHE QYTETARËVE | F. 8



### KULTURË

NËNTË ASETË TË REJA  
I SHTOHEN LISTËS SË  
TRASHËGIMISË PËR  
MBROJTJE TË PËRKOHSHME  
NGA RAJONI I PRIZRENIT | F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curez-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Në Francë hyn në fuqi ora policore

PARIS, 18 TETOR - Masat kundër koronavirusit kanë hyrë në fuqi më 17 tetor në Paris dhe në qytete të tjera të mëdha të Francës. Ky vendim i autoriteteve franceze vjen pas rritjes së rasteve të reja me Covid-19.

Nga ora 21:00 deri në orën 6:00 do të jetë ora policore, e cila pritet t'i afektojë 20 milionë njerëz. Kjo masë vjen pasi një ditë më parë autoritetet regjistruan më shumë se 25 000 raste me Covid-19 në mbarë Francën.

Përderisa ora policore ka marrë mbështetjen e publikut, zyrtarët në disa qytete franceze druan se masat kundër koronavirusit do të kenë ndikim të madh në aspektin

social dhe ekonomik të vendit. Masat në Francë do të jenë në fuqi për të paktën katër javë. Pronarët e restoranteve kanë kundërshtuar orën policore, duke thënë se kjo nuk ka kuptim, për shkak se tashmë autoritetet kanë vendosur rregulla strikte të distancës fizike.

Në mbarë Francën, po ashtu, janë ndaluar dasmat dhe ndejat e tjera publike dhe njerëzit janë udhëzuar që në tubimet private në shtëpi, të mos mblidhen më shumë se gjashtë persona.

Në gjithë Evropën së fundmi është regjistruar numër i lartë i rasteve të reja me koronavirus. Në 24 orët e fundit, Gjermania ka regjistruar 7 830 raste të reja,



shifra më e lartë e infektiveve ditore që prej se ka nisur pandemia. Në total, në Gjermani janë regjistruar 356

387 raste me koronavirus dhe 9 767 viktima.

Në Austri qeveria ka njoftuar se ministri i Jashtëm, Alexander

Schallenberg, është infektuar me koronavirus, pasi kishte marrë pjesë në një takim me homologët e tij të Bashkimit Evropian më 12 tetor, andaj si preventivë, të gjithë pjesëtarët e qeverisë austriake do t'i nënshtrohen testit për Covid-19.

Italia po mëton të vendosë masa të reja për ta frenuar përhapjen e koronavirusit, teksa brenda 24 orëve janë regjistruar 8 804 raste të reja me këtë virus.

Në Shtetet e Bashkuara kanë vdekur më shumë se 218 000 persona dhe mbi 8 milionë persona janë infektuar. Në mbarë botën, 1,1 milion persona kanë vdekur nga virusi dhe 39,2 milionë janë infektuar.

## Partia e Jacinda Ardern fiton zgjedhjet



WELLINGTON, 18 TETOR - Partia e kryeministres së Zelandës së Re, Jacinda Ardern, ka fituar zgjedhjet e përgjithshme. Me pothuajse të gjitha votat e numëruar, Partia e Punës e Ardern ka fituar 19 për qind të votave, duke bërë që kjo parti ta fitojë shumicën të madhe në parlament. "Zelanda e Re tregoi se Partia e Punës ka mbështetjen më të madhe në pothuajse 50 vjet", tha Ardern para mbështetësve, pasi shpalli fitoren. "Ne nuk do ta

marrim mbështetjen tuaj si të mirëqenë. Unë ju premtoj se ne do të jemi partia që do të qeverisë për të gjithë qytetarët e Zelandës së Re", shtoi ajo. Partia Popullore, e qendrës së djathtë, ka pranuar humbjen dhe aktualisht ka fituar 27 për qind të votave.

Partia e Ardern pritet të fitojë 64 ulëse në parlament, që janë të mjaftueshme që partia të ketë shumicën e plotë. Asnjë parti nuk ka arritur të fitojë kaq shumë ulëse, që prej vitit 1996, kur Zelanda e Re nisi së

zbatuari një sistem të ri të votimit.

Zgjedhjet e përgjithshme në Zelandë të Re fillimisht ishin paraparë që të mbaheshin në muajin shtator, por u shtyn për një muaj, për shkak të pandemisë së koronavirusit.

Votimet u zhvilluan të premten dhe mbi një milion persona vetëm kishin votuar paraprakisht më 3 tetor. Përveç zgjedhjeve të përgjithshme, qytetarët në Zelandë të Re kanë votuar edhe për dy referendume.

## Irani: Ka përfunduar embargoja e OKB-së për armët

TEHRAN, 18 TETOR - Ministria e Jashtme e Iranit ka njoftuar se embargoja e Kombeve të Bashkuara për shitjen e armëve ndaj Iranit ka përfunduar më 18 tetor, sipas kushteve të marrëveshjes bërthamore të vitit 2015, e arritur ndërmjet fuqive botërore dhe Teheranit. Ministria e Iranit ka njoftuar se ndalesa për armët është hequr duke thënë se të "gjitha kufizimet mbi transferimin e

armëve, aktivitetet e lidhura me të dhe shërbimet financiare për dhe nga Republika Islamike... që të gjitha përfundojnë automatikisht".

Në teori, Irani do të jetë përsëri në gjendje të blejë armë shtesë konvencionale të tilla si tanke, aeroplanë luftarakë dhe artileri të rëndë.

Heqja e embargos së armëve është kundërshtuar fuqishëm nga Shtetet e Bashkuara, duke

thënë se blerja e sërishme e armëve nga Irani është një kërcënim për sigurinë botërore. Por, ministria tha se Irani nuk ka nevojë të blejë shumë armë pasi doktrina e tij e mbrojtjes është e "bazuar në mbështetjen e fortë të njerëzit e tij dhe aftësitë vendore". Po ashtu, në deklaratën e Ministrisë së Jashtme iraniane thuhet se armët e shkatërrimit në masë "nuk kanë vend në doktrinën e mbrojtjes së Iranit".



## Merkeli u bën thirrje gjermanëve për disiplinë

BERLIN, 18 TETOR - Shifrat e Covidit në Gjermani kanë shënuar rritje. Në video-mesazhin e saj javor kancelarja Angela Merkel thekson se jemi në një fazë shumë serioze të pandemisë dhe se këto ditë e javë vendosin si

do të jetë ky dimër. Kancelarja gjermane Angela Merkel ka apeluar te disiplina e qytetarëve gjermane në luftë kundër përhapjes së virusit Korona. "Takohuni me sa më pak vetë, brenda apo jashtë shtëpisë. Ju

lutem: mos kryeni asnjë udhëtim që nuk është patjetër i nevojshëm, hiqni dorë nga çdo festim që nuk është patjetër i nevojshëm. Qëndroni, nëse është e mundur, në qytetin tuaj", u shpreh Merkel.

# Hoti kërkon kujdes maksimal pas rritjes së rasteve me Covid-19

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se institucionet po përgatiten që t'i përgjigjen rritjes së numrit të rasteve të reja me Covid-19, duke iu bërë thirrje qytetarëve për kujdes maksimal. Hoti ka thënë se pas rritjes së rasteve të reja me Covid-19, institucionet kanë bërë gati veprimet e nevojshme, për të evituar, siç u shpreh ai, një "mbyllje totale". Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit një pacient i infektuar me Covid ka vdekur dhe janë regjistruar edhe 137 raste të reja me këtë virus



duhet të tregojmë kujdes maksimal në punë, në shkollë, në biznes, në rrugë dhe në çdo aktivitet ku ka grumbullim të njerëzve. "Duhet të kemi mirëkuptim për t'i shmangur të gjitha tubimet publike të çfarëdo natyre, ashtu siç rekomandohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe IKShPK-ja", ka deklaruar kryeministri Hoti.

## Edhe një i vdekur dhe 137 raste të reja me Covid në Kosovë

Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 869 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 137 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve është raportuar një rast i vdekjes me Covid-19 (një rast

nga Spitali i Përgjithshëm, Prizren). Numri total i rasteve pozitive është 16 891 raste nga 80 058 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 653 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 49 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 14 666 raste, kurse numri i rasteve aktive është 1 572.

Rastet e fundit pozitive janë nga: komuna Prishtinë 54

raste, komuna Gjilan 20 raste, komuna Podujevë 17 raste, komuna Gjakovë 8 raste, komuna Lipjan 6 raste, komuna Rahovec 5 raste, komuna Fushë Kosovë 4 raste, komuna Pejë 4 raste, komuna Junik 3 raste, komuna Deçan 2 raste, komuna Ferizaj 2 raste, komuna Klinë 2 raste, komuna Skenderaj 2 raste dhe me nga një rast komunat Drenas, Istog, Mitrovicë, Novobërdë, Obiliq, Prizren, Suharekë dhe Viti.

## Këshilli i Sigurimit më 21 tetor, çfarë përmban raporti për Kosovën

PRISHTINË, 18 TETOR - Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara do ta mbajë takimin informues të radhës për Kosovën më 21 tetor. Është ky takimi i dytë për këtë vit, pas atij të mbajtur më 24 prill. Raporti për Kosovën u është shpërndarë ndërkohë të gjithë anëtarëve të Këshillit të Sigurimit. Mbi bazën e tij çdo anëtar i KS përgatit fjalën e vet. Raporti do të prezantohet shkurtimisht në Këshillin e Sigurimit nga shefi i UNMIK-ut, Zahir Tanin. Raporti mban 14 faqe të ndara në dhjetë pika, si dhe tre shtojca. Reportimi bëhet në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit, e

cila thotë se sekretari i përgjithshëm i OKB-së duhet të informojë rregullisht Këshillin e Sigurimit për zbatimin e mandatit të UNMIK-ut. Raporti aktual trajton periudhën 16 mars - 15 shtator të këtij viti. Katër faqet e para të raportit flasin për politikën kryesore dhe zhvillimet e çështjeve të sigurisë. "Sfida të ndryshme kanë hasur njerëzit dhe institucionet në Kosovë, por më kryesorja ka qenë Covid-19, krizë që, përveç ndikimit në shëndetin publik, ka pasur pasoja serioze politike, ekonomike dhe sociale", shkruhet në fillim të



raportit. Raporti numëron ndër zhvillimet politike heqjen e besimit qeverisë së Albin

Kurtit, dy muaj mbas qëndrimit në pushtet dhe ngritjen e akuzave nga Dhomat Speciale të Kosovës kundër

presidentit Thaçi dhe kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli, të cilat "e komplikuan më tej skenën politike të Kosovës".



Flet për "Epokën e re", Bilall Sherifi

# LAJÇAKU TË QËNDROJË EDHE NË DEKLARIMET PUBLIKE BRENDË ASAJ QË KËRKON NË TAKIME

Sekretari i përgjithshëm i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka bërë me dije se emisari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, duhet të qëndrojë edhe në deklaratimet publike brenda asaj që kërkon në takime. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se në takim me liderin e Nismës Socialdemokrate, përfaqësuesi i BE-së nuk e ka përmendur çështjen e ndryshimit të Kushtetutës së Kosovës për asociacionin e komunave me shumicë serbe. Sipas Sherifit, Lajçaku në takim ka thënë se asociacioni duhet të themelohet mbi bazën e marrëveshjes së vitit 2013 dhe mbi bazën e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë çështje

**EPOKA E RE**

Muhamet KOCI


PRISHTINË, 18 TETOR - Sekretari i përgjithshëm i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka kundërshtuar deklaratën e emisarit të BE-së në dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, për ta ndryshuar Kushtetutën e Kosovës për ta implementuar asociacionin e komunave me shumicë serbe. Ai ka deklaruar se në takimin që i dërguari i BE-së ka pasur me liderin e Nismës Socialdemokrate nuk e ka thënë një gjë të tillë.

Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Sherifi ka thënë se Lajçaku duhet të qëndrojë edhe në deklaratimet publike brenda asaj që kërkon në takime. "Konsideroj se z. Lajçak si

lehtësues/ndërmjetësues i dialogut në deklaratimet publike duhet të qëndrojë brenda asaj që ka kërkuar në takime dhe jo diçka tjetër të kërkojë në takime dhe diçka tjetër të deklarojë në publik", ka deklaruar Sherifi.

Ai ka treguar se Lajçaku në takim me zyrtarët e Nismës Socialdemokrate ka thënë se asociacioni duhet të themelohet mbi bazën e marrëveshjes së vitit 2013 dhe mbi bazën e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë çështje. "Në këtë takim, përveç të tjerave, është diskutuar edhe për çështjen e asociacionit, por aty z. Lajçak nuk deklaroi që duhet ndryshuar Kushtetuta e Kosovës. Përkundrazi, ai, që në hyrje të fjalës së tij deklaroi që asociacioni duhet të themelohet mbi bazën e marrëveshjes së vitit

2013 dhe mbi bazën e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë çështje", ka vlerësuar ai. Sherifi ka bërë me dije se Kosova duhet ta ofrojë asociacionin sipas marrëveshjes së vitit 2013 për njohje. "Qëndrimi i z. Limaj lidhur me asociacionin ishte i qartë, ai jo vetëm që duhet të formohet në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, por nuk mund të ketë asociacion as si të tillë pa njohjen e Kosovës nga Serbia. Pra, asociacioni për njohje, apo njohja për asociacion. Asgjë më pak", është shprehur ai. Sipas tij, Lajçaky para se të kërkojë nga Kosova ta ndryshojë Kushtetutën duhet të kërkojë nga Serbia ta ndryshojë Kushtetutën e saj. "Sepse është Serbia ajo që territorin e një shteti tjetër të pavarur dhe sovran, të njohur nga



2013 dhe mbi bazën e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë çështje. Qëndrimi i z. Limaj lidhur me asociacionin ishte i qartë, ai jo vetëm që duhet të formohet në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, por nuk mund të ketë asociacion as si të tillë pa njohjen e Kosovës nga Serbia. Pra, asociacioni për njohje, apo njohja për asociacion. Asgjë më pak! Prandaj, konsideroj se z. Lajçak si lehtësues/ndërmjetësues i dialogut në deklarimet publike duhet të qëndrojë brenda asaj që ka kërkuar në takime dhe jo diçka tjetër të kërkojë në takime dhe diçka tjetër të deklarojë në publik.

**“Epoka e re”:** Kjo ka nxitur reagime të shumta në shoqëri, por qeveria ende nuk ka reaguar. A është dashur të reagojë qeveria?

**Bilall Sherifi:** Reagimet që kanë ardhur nga të gjitha anët janë të drejta sepse z. Lajçak, para se të kërkojë nga Kosova ta ndryshojë Kushtetutën, duhet të kërkojë nga Serbia ta ndryshojë të sajën. Sepse është Serbia ajo që territorin e një shteti tjetër të pavarur dhe sovran, të njohur nga më shumë se 100 shtete, e mban në kushtetutë si pjesë të sajën! Padyshim që, në funksion të transparencës, Qeveria e Kosovës, përveç reagimeve përmes kanaleve zyrtare, duhet të deklarohet edhe publikisht për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me dialogun.

**“Epoka e re”:** Përsëri Kosova nuk po arrin një konsensus për dialogun me Serbinë. Cila duhet të jetë qasja e institucioneve të Kosovës ndaj kësaj faze të dialogut?

**Bilall Sherifi:** Jemi në përfundim të dekadës së parë të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të ndërmjetësuar nga BE-ja dhe, fatkeqësisht, vazhdon qasja e gabuar e deritashme pozitë-opozitë lidhur me dialogun me Serbinë. Prej fillimit të dialogut partitë politike çështjen e dialogut e kanë trajtuar jo nga këndvështrimi i interesit shtetëror, por nga këndvështrimi i interesit partiak. Kur janë në pushtet marrin pjesë në dialog, kur janë në opozitë refuzojnë të marrin pjesë!

**“Epoka e re”:** Përveç procesit të dialogut me Serbinë, Kosova po përballet edhe me Gjykatën Speciale. Me këtë shumicë që ka, a do të mund të përballet kjo qeveri me këto procese, apo do të jetë i nevojshëm zgjerimi i koalicionit qeverisës?

**Bilall Sherifi:** Nisma është deklaruar disa herë që vendit i duhet një qeveri me bazë më të gjerë, por mendoj që iniciativa për këtë çështje i takon bartësit të koalicionit, partisë që ka marrë mandatin nga presidenti për të formuar qeverinë, përkatësisht kryetarit të LDK-së, z. Isa Mustafa dhe kryeministrit të qeverisë, z. Avdullah Hoti.

# Gracka e ndryshimeve kushtetuese bllokoi dialogun

**PRISHTINË, 18 TETOR** - Deklaratat e përfaqësuesit të posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, në Prishtinë dhe në Beograd, lidhur me çështjen e formimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe, kanë dykuptimësi, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike Agon Maliqi dhe Bekim Baliqi. Lajçak gjatë qëndrimit në Prishtinë, më 15 tetor, ka deklaruar se lidhur me asociacionin ekzistojnë marrëveshjet e vitit 2013 dhe 2015, si dhe vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese, e cili ka thënë se asociacioni duhet të formohet në përputhshmëri me vendimin e kësaj gjykate. “Hapi i parë që duhet të diskutojmë është statuti dhe kjo është ajo çfarë presim. Asociacioni është pjesë e marrëveshjes gjithëpërfshirëse. Marrëveshja do të fillojë të zbatohet pas nënshkrimit”, ka thënë Lajçak në Prishtinë. Por, në Beograd, po të njëjtën ditë, Lajçaku kishte deklaruar se autoritetet e Kosovës i kanë thënë se do t’i përmbushin obligimet nga marrëveshjet në Bruksel, përfshirë edhe formimin e asociacionit. Siç ka thënë ai, qëndrimi i BE-së është që Serbia dhe Kosova duhet të bisedojnë “për procese shumë të rëndësishme dhe se është e logjikshme që Kushtetuta të ndryshohet”. “Për këtë askush nuk më tha se është e pamundur. Kushtetuta nuk është Bibël”, ka thënë Lajçak. Bekim Baliqi, profesor i shkencës politike në Universitetin e Prishtinës, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se deklaratat me dykuptimësi të Lajçakut janë kundërproduktive për vetë procesin e dialogut. Sipas tij, deklarata e Lajçakut në Beograd është një lloj ultimatum për Prishtinën, por këtë nuk e bëri ndaj Beogradit. “Pamë që palës serbe nuk i dha një lloj ultimatum që edhe ata duhet ta ndryshojnë Kushtetutën. Pra,

nëse Kushtetuta nuk qenka Bibël për ne, atëherë Kushtetuta nuk duhet të jetë Bibël as për Serbinë. Do të ishte gabim dhe jokorrekte që t’i kërkohej Kosovës që të bëjë një koncesion të radhës, gjë që do të mund të ishte pastaj fatale për vetë funksionimin e shtetit të Kosovës. Unë e kuptoj këtë si një lloj ultimatum, ndaj të cilës pala e Kosovës duhet të barrikadohet, e themi në kuptimin diplomatik, si dhe ta përcjellë mesazhin se kompromise të tilla nuk janë të mirëseardhura në Kosovë”, theksoi Baliqi.

Analisti Agon Maliqi thotë për “Radion Evropa e Lirë” se, pas deklaratave dykuptimëse të Lajçakut dhe qëndrimeve të ngurta të të dyja palëve, të Kosovës dhe të Serbisë, lidhur me kompetencat e asociacionit, topi tashmë mbetet te Bashkimi Evropian. Pa sqarimin e kësaj çështjeje, sipas tij, nuk do të ketë vazhdim të dialogut ndërmjet dy vendeve. “Tani jemi në pikën e ngecjes dhe me gjasat më të mëdha që të vazhdojë status quo-ja, sepse nëse insistohet që të diskutohet me Serbinë për kompetencat e statutit (të asociacionit) qysh tani, atëherë e shoh të vështirë pjesëmarrjen e Kosovës. Ndërsa nëse insistohet që kjo punë të lihet për më vonë ose për në fund, atëherë Serbia e ka bërë të qartë që nuk është e interesuar që të vazhdojë. Kështu që, i mbetet arbitrit, në këtë rast BE-së, por edhe Francës dhe Gjermanisë mbi të gjitha, për ta çuar këtë çështje në nivel pak më të lartë politik”, theksoi Maliqi.

Të dy njohësit e zhvillimeve politike vlerësojnë se insistimi i Serbisë që të bisedohet për asociacionin e komunave me shumicë serbe, por edhe deklaratat e Lajçakut për ndryshimet kushtetuese eventuale, janë grackë e cila çon drejt bllokimit të procesit të dialogut. Profesor Baliqi shpreh mendimin që në rast se Kosova do të pranojë që të hyjë në, siç i

quan ai, lojërat politike për ndryshimet kushtetuese, atëherë dokumenti i Ahtisarit, i cili është në themelin e Kushtetutës së Kosovës, si dhe mbi bazën e të cilit është shpallur pavarësia e vendit në vitin 2008, do të tejkalohet. Kjo, sipas tij, do të çonte në rishikimin e kornizës së deritashme të funksionimit të sistemit në Kosovë. “Serbia, deri vonë, nuk ka insistuar për asociacionin fare. Pra, prej vitit 2015 çështja e asociacionit ka qenë gati se tabu. Arsyeja pse Serbia po e ngrit këtë temë, është që të rritet presioni publik i opinionit publik në Kosovë, në mënyrë që të dështojë i gjithë ky proces dhe pastaj të hidhet faji te pala e Kosovës, se kine nuk janë të gatshëm për kompromis dhe se nuk kanë me kë të merren vesh”, theksoi Baliqi.

Edhe analisti Maliqi shpreh mendimin që kushtëzimi aktual i Serbisë për asociacionin është vetëm përpjekje për ta frenuar dhe bllokuar dialogun, duke e ditur situatën e brendshme në Kosovë. Sipas tij, Serbia është e interesuar që dialogu të dështojë, por duke e kornizuar këtë si për faj të Kosovës.

Analisti Maliqi ka shtuar që presioni eventual i BE-së ndaj Kosovës, do të jetë i pafytyrshëm dhe si rezultat të vetëm mund të jetë destabilizimi i situatës politike dhe shkuarja në zgjedhje parlamentare të reja. Kjo, sipas tij, do të rezultonte me krijimin e një qeverie të re të Kosovës, e cila do të kishte edhe më pak gatishmëri për të bashkëpunuar për dialog.

Por, megjithatë, siç thotë Maliqi, dialogu Kosovë - Serbi që zhvillohet në Bruksel, do të mbetet në pikën në të cilën është tani, deri pas zgjedhjeve presidenciale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat mbahen më 3 nëntor. Deri atëherë, të dyja palët, Kosova dhe Serbia, do të përpiqen t’i forcojnë pozicionet e veta.



më shumë se 100 shtete, e mban në Kushtetutë si pjesë të saj! Padyshim që, në funksion të transparencës, Qeveria e Kosovës, përveç reagimeve përmes kanaleve zyrtare, duhet të deklarohet edhe publikisht për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me dialogun”, është shprehur Sherifi.

**“Epoka e re”:** Z. Sherifi, emisari i BE-së në dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka deklaruar se mund të ndryshohet Kushtetuta e Kosovës për ta implementuar asociacionin e komunave me shumicë serbe. Si e keni parë këtë deklaram të tij?

**Bilall Sherifi:** Siç e dini edhe ju, z. Miroslav Lajçak para se të shkojë në Beograd ishte në Prishtinë dhe në kuadër të takimeve me drejtues të partive politike u takua edhe me kryetarin Nismës Socialdemokrate, z. Fatmir Limaj. Në këtë takim kemi marrë pjesë unë dhe zëvendëskryeministria, znj. Albulena Balaj Halimaj. Në këtë takim, përveç të tjerave, është diskutuar edhe për çështjen e asociacionit, por aty z. Lajçak nuk deklaroi që duhet ndryshuar Kushtetuta e Kosovës. Përkundrazi, ai, që në hyrje të fjalës së tij deklaroi që asociacioni duhet të themelohet mbi bazën e marrëveshjes së vitit

## Avokat i Popullit: Institucionet të jenë të kujdesshme, s'do ketë tolerancë aty ku shkelet ligji

PRISHTINË, 18 TETOR - Avokat i Popullit, Naim Qelaj, vlerëson se përzgjedhja në pozita të larta shtetërore, qoftë në sistemin e drejtësisë dhe në ekzekutiv, duhet të përmirësohet. Qelaj, i cili ka më pak se një muaj që është në krye të këtij institucioni, thotë se kandidimet nuk duhet të bëhen nga persona që mund të ndikojnë në proces.

Në një intervistë për "KosovaPress", ndër të tjera, Qelaj ka folur edhe për të kaluarën e vet politike. Avokati i Popullit, Naim Qelaj, derisa ka komentuar tërheqjen e Ambasadës Amerikane dhe Bashkimit Evropian nga procesi i zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Prokurorial dhe kryeprokurorëve të prokurorive themelore, ka thënë se ndajnë shqetësimet e njëjta në këtë drejtim. Ai ka shtuar se qytetarët kanë nevojë ta rrisin besueshmërinë tek institucionet ligjvënës me qëllim që mos të hezitojnë t'i adresojnë shqetësimet e tyre. "Konsideroj se praktikat e përzgjedhjes dhe rekrutimit në

pozita të larta shtetërore, pavarësisht që a janë në gjyqësor apo ekzekutiv, duhet të përmirësohen sepse vetëm kështu ne mund t'i kontribuojmë fuqizimit të zbatimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës dhe pa dyshim që ndoshta është një prej segmenteve më të rëndësishme, sepse përmes këtyre zgjedhjeve po ndikohet në besimin e qytetarëve nëpër institucione. Çështja e të drejtës për kandidim është e drejtë e pamohueshme, duhet ta ketë secili qytetar që i plotëson kushtet ligjore për pozitën që bëhet shpallja, megjithatë duhet të jemi të kujdesshëm që këto kandidime të mos bëhen nga persona që mund të ndikojnë në vetë proces", ka theksuar Qelaj.

Avokati i Popullit ndër vite ka pranuar ankesa të shumta për konkurset publike e për këtë, Qelaj paralajmëron hetim të përgjithshëm. "Duhet ta bëjmë një analizë më të thellë në këtë drejtim sepse konsideroj se në këtë aspekt qytetarët tanë ballafaqohen me probleme të



shumta për mosrespektimin e të drejtave të tyre nga marrëdhënia e punës, sidomos vlen të ceket sektori privat, por edhe në sektorin publik nuk qëndrojnë punët më mirë sepse, edhe përkundër avancimit të ligjit, ka pasur

ankesa të shumta në institucion. Kam arritur të kuptoj mosrespektim të institutit të konkursit publik që lidhet drejtpërdrejt me kriteret e përzgjedhjes dhe vlerësimit dhe në anën tjetër me përzgjedhjen e personit që i

plotëson ato kriteret duke qenë të ndikuar nga jashtë. Ndoshta në këtë drejtim institucioni në të ardhmen duhet të fillojë të bëjë një hetim të përgjithshëm dhe të nxjerrë një konstatim të përgjithshëm për gjendjen", ka thënë Qelaj.

## Vetëvendosja nuk i beson Hotit për asociacionin



PRISHTINË, 18 TETOR - Lëvizja Vetëvendosje nuk po u zë besë deklaratave të kryeministrit Avdullah Hoti se nuk do ta hapë temën e asociacionit të komunave serbe në dialogun me Serbinë.

Partia e Albin Kurtit konsideron se ndërrimi i shpeshtë i qëndrimeve të kreut të qeverisë e bën të pabesueshëm atë. Anëtarja e kryesisë e Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës, Arbërie Nagavci, në një intervistë për "KosovaPress" ka thënë se tema e themelimit të asociacionit të komunave serbe duhet të jetë e mbyllur për Kosovën. "E para punës, zotëri Hoti nuk është një njëri që nuk i ka ndryshuar qëndrimet e tij. Kemi parë jo nga muaji në muaj, por nga dita në ditë ndryshim të

deklaratave. Çfarë thotë sot nuk e thotë nesër dhe kjo nuk është një gjë e mirë. Në anën tjetër, edhe në lidhje me asociacionin ka përdorur deklarata që kjo çështje është temë e mbyllur, por ka thënë edhe se ne kemi marrëveshje të vitit 2013 atë të vitit 2015 dhe kemi vendimin e Gjykatës Kushtetuese. E që vendimi i saj e bën të pazbatueshme marrëveshjen e vitit 2015 dhe asaj 2013. Por ai i ka përmendur të gjitha. Kështu që nga e kaluara e tij dhe këtu duhet të kemi parasysh s'mund t'u besojmë fjalëve që ai thotë... Lajçak nuk e ka hapur fare këtë çështje me Lëvizjen Vetëvendosje dhe besoj që ai si një diplomat e ka të qartë se për Lëvizjen Vetëvendosje sikur në vitin 2013-2015 e ashtu edhe sot është një temë e mbyllur", ka thënë Nagavci.

## Nënshkruhet memorandumi mes Universitetit 'Ukshin Hoti' dhe Yenilikçi Admiral Derneği

Prizren, 18 tetor (ER) - Me rastin e përfundimit të konferencës ndërkombëtare "Eurasian Conference on Language & Social Sciences", e mbajtur nga 16-18 tetor 2020, në Antalya të Turqisë, u bë nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes përfaqësuesit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, prof. ass. dr Armend Podvorica, prorektor për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë dhe përfaqësuesit të Yenilikçi

Admiral Derneği - prof. dr. Hasan Karacan. Memorandumi i Mirëkuptimit parasheh bashkëpunimin në aplikimin e risive në aktivitetet e shoqërisë, bashkëpunimin në pjesëmarrjen e realizimit të projekteve të karakterit vendor dhe ndërkombëtar dhe në mbështetjen e aplikimit të metodave dhe teknikave bashkëkohore në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Gjithashtu, ky memorandum parasheh mundësinë e ndihmesës së studentëve në realizimin e projekteve hulumtuese për programet master dhe të doktoratës. Konferenca ndërkombëtare "Eurasian Conference on Language & Social Sciences", e mbajtur nga 16-18 tetor 2020, në Antalya të Turqisë, është mbështetur me disa punime shkencore nga stafi i rregullt i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.



# Bekim Jashari kërkon të ndryshohet Kushtetuta për t'ua hequr serbëve votimin e dyfishtë

Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka reaguar ndaj deklaratës së emisarit special të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, i cili ka kërkuar që të ndryshohet Kushtetuta e Kosovës për asociacionin e komunave me shumicë serbe. Kryetari Jashari ka thënë se në asnjë mënyrë dhe për asnjë çmim nuk duhet dhe nuk mund të ndryshohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në emër të arritjes së marrëveshjes përfundimtare me Serbinë. Ai ka kërkuar që Kushtetuta e shtetit tonë duhet të ndryshohet vetëm për ta hequr votimin e dyfishtë të komunitetit serb në Kuvend

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 TETOR - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka reaguar ndaj deklaratës së emisarit special të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, i cili ka kërkuar që të ndryshohet Kushtetuta e Kosovës për asociacionin e komunave me shumicë serbe. Jashari përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se në asnjë mënyrë dhe për asnjë çmim nuk duhet dhe nuk mund të ndryshohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në emër të arritjes së marrëveshjes

përfundimtare me Serbinë. "Shteti ynë ka bërë vazhdimisht kompromise të dhimbshme në emër të arritjes së marrëveshjeve me Serbinë, duke përfshirë diskriminimin pozitiv të pakicës serbe në Kosovë dhe votimin e dyfishtë për çështje substanciale si pjesë e kushtetutës sonë. Ajo që duhet ta ndryshojë Kushtetutën është Serbia, e cila, përveç kësaj, duhet dhënë përgjegjësi për të pagjeturit, viktimat e luftës, gjenocidin mbi popullatën e pafajshme dhe dëmet materiale të shkaktuara në luftën e fundit në Kosovë", ka thënë Jashari. Ai ka shtuar se Kushtetuta e shtetit tonë duhet të ndryshohet

vetëm për ta hequr votimin e dyfishtë si derivat i pakos së Ahtisarit dhe i cili pengon të ardhmen dhe zhvillimin e shtetit tonë. "Udhëheqësit tanë shtetërorë duhet t'ia bëjnë me dije faktorit ndërkombëtar që shteti ynë nuk ka për të bërë më kompromise dhe se jemi shteti më i avancuar në Ballkan sa i përket respektimit të të drejtave të pakicave. Është koha e fundit që spektri politik në vend të jetë i bashkuar ta mbrojë shtetin

tonë nga çdo tendencë që mund të vijë për ta futur atë në negociata e kompromise të dhimbshme. Çdo veprim i sotëm i udhëheqësve tanë duhet të jetë konform Kushtetutës dhe duke mos prekur në asnjë mënyrë shtetësinë, sovranitetin dhe territorialitetin e shtetit tonë", ka deklaruar kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari. Kërkesa e emisarit të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë -

Serbi, Miroslav Lajçak, e bërë gjatë vizitës në Beograd për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe, se mund të ndryshohet Kushtetuta e Kosovës, ka nxitur reagime të shumta në Kosovë. Zyrtarët politikë dhe shoqëria civile në Kosovë kanë thënë se pretendimet e tilla janë shqetësuese. Sipas tyre, ajo që duhet të ndryshohet është Kushtetuta e Serbisë dhe jo ajo e Kosovës.

## PDK-ja: Mungesa e kolektorit të ujërave të zeza në lagjen "Kalabria" rrezikon shëndetin e qytetarëve



Mungesa e kolektorit të ujërave të zeza në lagjen "Kalabria" ishte tema që u shtjellua në konferencën e së dielës nga zyrtarë të PDK-së në Prishtinë. Asamblistët e PDK-së në Komunën e Prishtinës, Leutrim Retkoceri dhe Suzana Vuqitërna-Kika, kanë shprehur shqetësimin e tyre për pasojat në shëndetin e qytetarëve dhe funksionimin e bizneseve në këtë lagje nga kundërmimi dhe vërshimi i ujërave të zeza

Prishtinë, 18 tetor (ER) - Dega e Partisë Demokratike të Kosovës në Prishtinë ka kritikuar qeverisjen e kryeqytetit për mungesën e kolektorit të ujërave të zeza në lagjen "Kalabria". Asamblisti i PDK-së në Prishtinë, Leutrim Retkoceri, e ka konsideruar të pafalshme që të gjitha qeverisjet komunale që kanë udhëhequr deri tani Prishtinën ua kanë kthyer shpinën qytetarëve dhe i kanë lënë ata të përballen me

qindra probleme. "Po shohim këtu lagjen Kalabria, ku qytetarët e saj janë lënë nën kundërmimin e erërave të ujërave të zeza. Premtime të pafundme, i janë dhënë kësaj lagjeje nga të gjitha partitë që kanë udhëhequr kryeqytetin, nga LDK-ja dhe nga LV-ja. Qeverisja aktuale karakterizohet me zvarritje të pafundme të punimeve, ku 180 ditë të caktuara për secilin projekt

të nisur nuk përfundojnë para tri apo tetë vjetëve", ka thënë Retkoceri në një konferencë për media.

Edhe asamblistja tjetër e PDK-së në Prishtinë, Suzana Vuqitërna-Kika, ka deklaruar se mosveprimi nga ana e komunës për vendosjen e kolektorit po e rrezikon jetën e fëmijëve, shëndetin e qytetarëve, shtëpitë e tyre dhe funksionimin e bizneseve në lagjen Kalabria. "Unë jam e shqetësuar për fëmijët e kësaj lagjeje që dalin të luajnë dhe shkojnë në shkollë në këtë periudhë kur ka reshje të shpeshta të shiut. Ata rrezikojnë të bien në gropat e thella me ujë dhe paramendojeni se çfarë mund të ndodhë. Kjo gjendje është tejet e rrezikshme për shëndetin e secilit banor të lagjes 'Kalabria', sepse ekziston rreziku i përhapjes së infeksioneve ose ndonjë epidemie pikërisht nga kundërmimi i ujërave të zeza", ka thënë Vuqitërna-Kika.

## Këshilli i Investitorëve Evropianë dënon sulmin ndaj Raiffaisen Bank Kosova

PRISHTINË, 18 TETOR (ER) - Si përfaqësues i investitorëve evropianë në Kosovë, Këshilli i Investitorëve Evropianë e ka dënuar sulmin ndaj degës së Raiffaisen Bank Kosova në Ferizaj. Sipas njoftimeve nga autoritetet, banka është dëmtuar me mjete plasëse dhe janë shkaktuar dëme të

konsiderueshme. "Veprimet e tilla të dhunshme ndaj investitorëve të huaj, nga kushdo që bëhen, përveçse veprime kriminale, janë kërcënime për zhvillimin ekonomik të vendit, cenojnë rendin dhe ligjin dhe janë të dënueshme. Këshilli i Investitorëve Evropianë u

bënë thirrje autoriteteve të vendit që t'i ndërmarrin veprimet e nevojshme që aktorët e këtij sulmi të nxirren para drejtësisë dhe ta marrin dënimin e merituar", është thënë në reagim, duke u shtuar se Raiffaisen Bank është investitore lidere në sektorin bankar në vend.



## Osmani: Shteti ka mbi gjysmë miliardi euro borxhe ndaj bizneseve dhe qytetarëve



PRISHTINË, 18 TETOR - Mbi gjysmë miliard euro ka arritur borxhi i shtetit ndaj kompanive dhe qytetarëve në vend. Këto borxhe janë në rritje vazhdimisht dhe kështu po kërcënohet seriozisht buxheti i shtetit. Shqetësues gjendja mbetet që në disa organizata buxhetore dhe në Telekomin e Kosovës vazhdojnë të japin paga për punëtorë pa shkuar në punë fare.

Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, thotë se janë tri

kërcënime serioze që po i bëhen buxhetit të shtetit nga borxhet e mëdha të shtetit ndaj qytetarëve dhe bizneseve, nga rënia e të hyrave buxhetore dhe nga borxhi i jashtëm. Osmani në një intervistë për "KosovaPress" thotë se duke i llogaritur obligimet, sipas të gjitha bazave, operatorët ekonomikë dhe qytetarët kanë pretendime financiare ndaj qeverisë mbi 556 milionë euro që, sipas tij, ky trend është në rritje. "Nëse këto tri nuk menaxhohen mirë,

buxheti kërcënohet në mënyrë serioze dhe të bëhet i aftë për t'i financuar institucionet e shtetit. Fatkeqësisht, dy të fundit, borxhet kundrejt qeverisë nga bizneset dhe qytetarët po rriten prej 16-përqindësh në krahasim me vitin paraprak. Ky është një tregues shumë i dëmshëm, njëkohësisht është edhe një alarm për institucionet që kanë përgjegjësi ta përmirësojnë këtë. Përkundër kësaj, është treguesi tjetër që po rriten edhe borxhet e qeverisë ndaj

bizneseve. Prandaj, me efikasitetin e sistemit gjyqësor dhe të përmbaruesve, ne do të jemi në një pozitë kur qeveria duhet t'i paguajë këto borxhe, derisa në anën tjetër është në pozitë që nuk mund të inkasosh dhe në anën tjetër duhet t'i paguash. Në këtë formë natyrisht që vjen kërcënimi. Këto borxhe kanë kaluar shifrën prej 500 milionë eurosh. Borxhi i jashtëm është pak mbi 1 miliard euro", ka thënë Osmani. Në anën tjetër shumica e

borxheve të qytetarëve dhe bizneseve ndaj qeverisë është pothuajse e njëjtë me atë të vitit paraprak, mbi 637 milionë euro janë borxhe të pambledhura, nga të cilat në nivel qendror janë 452 milionë euro dhe në nivel lokal 185 milionë euro. Pjesa dërrmuese e borxheve të pambledhura ka të bëjë me ATK-në dhe Doganën, të cilat së bashku kanë 404 milionë euro borxhe të pambledhura apo rreth 64 për qind të shumës totale.

## Më 23 tetor do të mbahet ankandi i njëmbëdhjetë i letrave me vlerë për vitin 2020

PRISHTINË, 18 TETOR (ER) - Ministria e Financave ka njoftuar se më 23 tetor do të mbahet ankandi i dymbëdhjetë për vitin 2020. Në këtë ankand do të

emetohen obligacione me maturitet trevjeçar në shumën prej 25 milionë eurosh. "Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për

Borxhin Publik, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen tri vjet dhe është tërësisht i liruar nga tatimi. Për detaje rreth pjesëmarrjes në

ankande për blerjen e letrave me vlerë, ju lutem kontaktoni ndonjërin nga Bankat Komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës", ka njoftuar Ministria e Financave.





# Kosova akuzon Serbinë për shkeljen e CEFTA-s

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka kërkuar që emërtimi UNMIK-Kosovo të hiqet dhe të jetë vetëm Kosova, të zbatohet marrëveshja për shenjen e konfirmimit dhe të njihen kualifikimet profesionale. Po ashtu, ka kërkuar që t'i bëhet presion Beogradit që bizneset dhe prodhimet e Kosovës të mos kenë pengesa kur kalojnë transit nëpër Serbi

PRISHTINË, 18 TETOR - Shteti i Serbisë po vazhdon ta shkelë marrëveshjen për Tregti të Lirë me Evropën Qendrore, që njihet me shkurtesën CEFTA, thotë ministri i Tregtisë dhe Industrisë në Qeverinë e Kosovës, Vesel Krasniqi. Për ta zgjidhur këtë problem, Krasniqi tregon se të enjten ka kërkuar nga drejtori i CEFTA-s, Emir Gjikiq, që të bëjë presion mbi Serbinë që ta zbatojë marrëveshjen, në të kundërtën, thotë ai, Kosova do të marrë masa, pa treguar se për çfarë masash bëhet fjalë. CEFTA është një marrëveshje ndërkombëtare e krijuar nga ana e Bashkimit Evropian, me qëllim të lehtësimit të këmbimeve tregtare të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Ministri Krasniqi ka kërkuar që emërtimi UNMIK-Kosovo të hiqet dhe të jetë vetëm Kosova, të zbatohet marrëveshja për shenjen e konfirmimit dhe të njihen kualifikimet profesionale. Po ashtu, ka kërkuar që t'i bëhet presion Beogradit që bizneset

dhe prodhimet e Kosovës të mos kenë pengesa kur kalojnë transit nëpër Serbi.

Në tregun e Kosovës, mallrat e importuara nga vendet anëtare të CEFTA-s duhet të hyjnë me shenjen e konfirmimit, të vendosura në produkte, që është shenja CE. Përmes shenjës CE prodhuesi tregon që produkti është në konformitet i vlerësuar në aspektin e sigurisë dhe shëndetit, sipas standardeve të kërkuara nga Bashkimi Evropian. Certifikata CE zbatohet në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, por mallrat e Serbisë nuk kanë shenjë, thotë Krasniqi. "Ndërsa shteti fqinj, Serbia, nuk e zbaton këtë dhe mallrat që vijnë nga Serbia janë me tri AAA (shenjë e produkteve serbe), do të thotë është shkelje e marrëveshjes që nuk u lejohet të futen në Kosovë. Përveç CEFTA-s, këtë çështje e kam ngritur edhe te kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti. Kam dërguar shkresë edhe në Zyrën Amerikane në Kosovë, në zyrën e

Bashkimit Evropian. Po presim reflektim, në të kundërtën unë do ta zbatoj marrëveshjen sepse nuk mund të presim pafundësisht", shton ai.

Edhe në bazë të Ligjit për kërkesat teknike për produktet dhe vlerësim të konfirmimit, miratuar në vitin 2018 nga Kuvendi i Kosovës, Dogana e Kosovës mund ta pezullojë lëshimin e një produkti në qarkullim të lirë në treg, nëse shenja CE është vendosur në produkt në mënyrë false ose mashtruese.

## Pengesat e bizneseve që kalojnë transit nëpër Serbi

Përveç shenjës së konfirmimit, ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka kërkuar që Beogradi zyrtar mos t'i pengojë bizneset dhe prodhimet e Kosovës që kalojnë transit nëpër territorin e Serbisë. "Është duke vendosur barriera për mallrat që kanë destinacion Kosovën, që kalojnë transit nëpër Serbi, i hap ato dhe i obligon që të fshihet mbishkrimi Republika e Kosovës dhe të shkruhet 'Kosova dhe Metohija' siç e kanë ata (Serbia)", thotë ministri Krasniqi.

Një nga kompanitë që ballafaqohet me këtë problem është industria e mishit "Calabria" nga Gjilani. Pronari i kësaj kompanie, Xhelal Selimi, tregon se Serbia nuk njihet certifikatën fitosanitare të

lëshuar nga Republika e Kosovës. "Unë tentoj që ta shfrytëzoj territorin e Serbisë për të eksportuar mallra në Kroaci, por nuk kemi sukses. Ky është problemi kryesor", thotë Selimi për "Radion Evropa e Lirë".

Certifikatë fitosanitare është dokumenti që e vërteton gjendjen shëndetësore të dërgesës, që lëshohet nga shërbimi fitosanitar për shëndetin e mallrave nga vendi i prejardhjes.

Edhe Arian Zeka, kryeshef ekzekutiv në Odën Ekonomike Amerikane në Prishtinë, tha se janë evidente ankesat e bizneseve për këto probleme. Kryesisht, thotë ai, problemet kanë të bëjnë me mosnjohjen nga Serbia të dokumentacionit që lëshohet nga autoritetet e Republikës së Kosovës.

Zeka tregon se CEFTA parasheh edhe dispozitat e trajtimit të barrierave në tregtinë e lirë mes vendeve nënshkruese të kësaj marrëveshjeje. "Odë Amerikane gjithmonë ka qenë ithtare e shfrytëzimit të këtyre mundësive që parashihet në marrëveshje, pra shfrytëzimin e mekanizmave institucionalë të CEFTA-s, për adresimin e këtyre pengesave, para se të shkohet me masa më ekstreme", tha Zeka.

Pavarësisht prej problemeve, gjatë këtij viti vlera e mallrave që Serbia ka eksportuar në Kosovë është rreth 107 milionë euro, përderisa shuma e produkteve të Kosovës që kanë dalë në tregun e Serbisë është 19

milione euro, thotë Adriatik Stavileci, zëdhënës në Doganën e Kosovës.

Kosova në këtë mekanizëm vazhdon të përfaqësohet si UNMIK dhe jo si Republika e Kosovës. Për këtë ministri, Vesel Krasniqi tregon se ka kërkuar nga udhëheqës të CEFTA-s që të hiqet ky emërtim. "Sepse UNMIK-u [Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë] nuk ka më dhe ne përfaqësohemi me zyrtarë dhe si ministri e Qeverisë së Republikës së Kosovës", tha ai. Në këtë mekanizëm, Republika e Kosovës është anëtarësuar në vitin 2007. Për shkak se në atë periudhë Kosova nuk e kishte të zgjedhur statusin, marrëveshja ishte nënshkruar nga shefi i atëhershëm i UNMIK-ut, Joachim Rucker.

Në këtë mekanizëm, përveç Kosovës, vendet e tjera anëtare të CEFTA-s janë: Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi, Bosnjë e Hercegovina dhe Moldavia.

Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga ish-kryeministri Ramush Haradinaj, në nëntor të vitit 2018 kishte vendosur taksë doganore 100 për qind për të gjitha produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnjë Hercegovina. Kurse qeveria e kaluar, e udhëhequr nga ish-kryeministri Albin Kurti, në prill të këtij viti ka zëvendësuar taksën me masën e reciprocitetit. Por, me të marrë detyrën, kryeministri Avdullah Hoti hoqi masën e reciprocitetit.



## Nëntë asete të reja i shtohen listës së trashëgimisë për mbrojtje të përkohshme nga rajoni i Prizrenit

PRIZREN, 18 TETOR (ER) - Listës së Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme për vitin 2021 i janë shtuar edhe nëntë asete të reja nga regjioni i Prizrenit. Regjistri i listës për këtë vit është definuar dhe përmban propozimet dhe vlerësimet përkatëse nga institucionet dhe palët e autorizuar me ligj për këto propozime. Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren, në përmbushje të detyrimeve ligjore, gjatë procesit të inventarizimit, dokumentimit dhe vlerësimit për vitin 2021 ka propozuar nëntë asete për t'u përfshirë në regjistrin e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme në kategorinë arkitekturore.

Të gjitha asetet nga rajoni i Prizrenit që i janë propozuar Komisionit Profesional Shqyrtues të Kërkesave dhe Propozimeve për Përfshirjen

në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme janë aprovuar dhe lista ka marrë miratimin e ministres së Kulturës, Vlora Domoshi.

Disa nga asetet, të cilat janë përfshirë këtë vit si propozime të reja në listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme nga rajoni i Prizrenit janë: Shkolla e vjetër e fshatit Mushnikovë; Kompleksi i Xhamisë së vjetër në fshatin Leskovec; Kompleksi i Sarajit të vjetër; Ish-hotel 'Selaniku' (strehimorja e vjetër e grave); Ish Hotel 'Andi' (Qendra Kulturore Hebraike); Shtëpia e familjes Rada; Koji i vjetër në Rahovec; Shtëpi guri e familjes Hoxha në fshatin Zhur, si dhe Rrënojat e xhamisë së vjetër në fshatin Shkozë të Malishevës. "Aktualisht procesi i vlerësimit është përmbyllur me procedurë të brendshme administrative në MKRS për



publikim dhe shpallje me akt administrativ", ka theksuar drejtori i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren, Samir Hoxha, i cili ka falënderuar të gjitha palët e

angazhuara, në çfarëdo forme, në debatin dhe procedurat e tjera të aprovimit të listës, si zërat e opinionit publik, personat fizikë të përfshirë në cilësi të ndryshme në këtë

proces, e me theks të veçantë punonjësit profesionalë të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren për përmbylljen me sukses të këtij angazhimi.

## Hyrja me vetura në qendër të Prishtinës do të bëhet me pagesë



PRISHTINË, 18 TETOR - Në të katër anët e kryeqytetit, të gjitha automjetet që vijnë nga vendet e tjera, do të duhet të paguajnë hyrjen. Komuna e Prishtinës po planifikon që në muajin nëntor të merret një vendim i tillë, derisa ai pritet të hyjë në fuqi nga viti i ardhshëm. Kryetari i Komunës së

Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se përmes projektit në të cilin parashihet të ndërtohen edhe unazat, parashihet edhe zgjidhja e problemit të trafikut të ngarkuar. Sipas tij, hyrja me pagesë në kryeqytet do ta eliminojë tollovinë në komunikacion pasi që, siç thotë ai, zgjerimi i rrugëve nuk është zgjidhje.

"Diku në nëntor fillojmë një projekt të ri, për të cilin jemi para nënshkrimit. Besoj se do të mund ta implementojmë nga viti tjetër. Do të ketë edhe pagesa për hyrje në kryeqytet. Prishtina është qytet i vogël, prej skajit në skaj për gjysmë ore mund të të ecësh këmbë", ka thënë kryetari Ahmeti.

## Ali Berisha: AAK-ja po rikthehet në Pejë

PEJË, 18 TETOR (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Dega në Pejë, njëherësh deputet i Kuvendit të Kosovës, Ali Berisha, ka mbajtur një takim me kryetarë të nëndegëve në këtë komunë. Berisha në një shkrim publikuar në "Facebook" ka thënë se kanë pasur një diskutim të rëndësishëm për fillimin e procesit të propozimeve të kandidatave për kryetar të Pejës nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës në Pejë. Aleanca e ka momentin. Është duke u mobilizuar dhe do të rikthehet", ka thënë Berisha.

trendë normalë të zhvillimit. AAK-ja - Dega në Pejë - po përgatitet për rikthim. Sot, në takim me kryetarë të nëndegëve. Diskutim i rëndësishëm, duke respektuar normat demokratike dhe statutare për fillimin e procesit të propozimeve të kandidatave për kryetar të Pejës nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës në Pejë. Aleanca e ka momentin. Është duke u mobilizuar dhe do të rikthehet", ka thënë Berisha.



Analizë

# MUZGU I NGJASHMERIVE HISTORIKE



Fehmi AJVAZI

Çekosllovakia kishte një fat të ngjashëm me ish-Jugosllavinë: ditëlindjen shtetërore! Të dy vendet u themeluan në vitin 1918, në vigjilje të përfundimit të Luftës së Parë Botërore (1914-1918). Formimi i tyre erdhi si rezultat i "prerjes cezariene" të hartës së Evropës nga vetë evropianët. Madje lindja e tyre u vendos qysh në embrion nga fuqitë e mëdha që dolën fitimtare në njërin prej luftërave më të pakuptimta të historisë njerëzore. Pak a shumë, ngjashmëritë pastaj s'ishin të rastit: të dyja këto federata u përbën nga shumica e popujve dhe e komuniteteve sllave. Pati veç një përjashtim dallues: se në territorin e Jugosllavisë, që prej themelimit të saj si mbretëri, u la të jetonte një popull aspak minoren: shqiptarët!

Historia e shqiptarëve që mbeten jashtë Shqipërisë ka një histori voluminoze (të vështirë e tragjike) që lidhet direkt me Beogradin. Edhe sot kjo "histori" riciklohet brenda korpuseve ku goditet liria dhe drejta e Kosovës e cila, përgjatë shekullit XX, u shndërrua si njëra prej çështjeve më tragjike kombëtare shqiptare. Në këtë shkrim s'kemi për qëllim shtjellimin e tragjedisë së Kosovës, po pse çështja e Kosovës lidhet sot me ish-Çekosllovakinë?

Këtë verë bëhen 28 vjet qëkur ish-Jugosllavia federale pushoi (zyrtarisht) së ekzistuari si shtet me vendim të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (1992). Në anën tjetër, përgjatë fazës së

shpartallimit si shtet, ish-Jugosllavia me kohëra në një agoni të thellë prej rrëmujeve politike dhe nga luftërat e përgjakshme mes kombeve dhe komuniteteve që e kishin përbërë këtë federatë. Fiks një vit më vonë, më 1 janar 1993, edhe Çekosllovakia pushoi së ekzistuari. Ajo u nda në mënyrë paqësore në dy shtete. Kështu, bilanci i shpartallimit të Çekosllovakisë dhe sidomos bilanci i "vdekjes" së ish-Jugosllavisë pati për rrjedhojë lindjen e 9 shteteve të reja: nga ish-federata çekosllovakë lindën Çekia dhe Sllovakia, dhe nga ish-Federata Jugosllave lindën Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia dhe Kosova.

Tri nga këto 9 shtete nuk e kanë njohur Kosovën. E këto janë: Bosnja dhe Hercegovina, Sllovakia dhe Serbia. Kjo e fundit, Serbia, shkaktare e marrëdhënieve të këqija me shqiptarët dhe jo vetëm me shqiptarët, vazhdon t'i ruajë edhe sot në sirtarë të vet planet e terrorit dhe të dhunës, gjithnjë me idenë për rikthim në Kosovë, pas largimit me turp më 1999 nga Kosova. Krahas ëndrrave kolektive serbomëdha, Serbia edhe sot angazhohet me të gjitha forcat për de faktorizimin e vazhdueshëm të shtetësisë së Kosovës, angazhohet për de stabilizimin, sabotimin dhe rrënimin e Kosovës.

Defaktorizimi, domethënë mohimi dhe eliminimi i shtetësisë së Kosovës nga Serbia, lidhet edhe me politikën që ndjekin ndaj Kosovës dy "binjakët" e dikurshme: Sllovakia dhe, në një masë, edhe Çekia. Qysh? Sllovakia hynë në listën e pesë shteteve evropiane që nuk e kanë njohur Kosovën. Sllovakia është edhe anëtare e BE-së, mirëpo nuk ka ndjekur rrugën e shumicës së anëtarëve të tjerë që e kanë

njohur Kosovën. Mbase në thelbin e një analize të këtillë, këtu do të duhej të përfundonte rrëfimi për këtë shtet! Mirëpo, nuk është kështu! Në kontekst, edhe Çekia shfaq herë pas here qëndrime dualiste, madje edhe kundërshtuese ndaj shtetit të Kosovës. Ky shtet ka në krye një president me një emër të popullarizuar në hapësirat ortodokse ballkanike: "Milosh" (Milosh Zeman).

Presidenti çek është goxha injorues dhe mohues i pavarësisë së Kosovës. Ky jo njëherë ka deklaruar me agresivitet se, mbi të gjitha, duhet të tërhiqet njohja çeke e Kosovës! Fatkeqësisht, nuk është vetëm presidenti Zemanai që e mban gjallë "historinë" e qëndrimeve të këtilla brenda çeke kundër shtetit të Kosovës. Një ish-eurodeputet çek, Richard Falbr, madje nga një parti politike me orientim demokratik, ka qenë i njohur për averzionin dhe për akuzat e tij të hapura kundër UÇK-së dhe drejtuesve të saj. Prototipi i vërtetë i Dick Martit, Falbr ka mblaçitur në opinion asgjë më shumë se paragrafët me prejardhje njëqind për qind serbe. Ja, përmbajtja e një paragrafi "serbo-falbrian" kundër ish-kryeministrit Hashim Thaçi: "Ai, kur rekrutonte njerëz për UÇK-në, në një rast në një fshat u tha prindërve: ose më jepni 10 mijë marka gjermane ose birin tuaj. Dhe në qoftë se dikush refuzonte, ai i vinte zjarrin shtëpisë" (6 shkurt, 2014. I NDNES.cz).

Siç thashë më lart, rrëfimi për Sllovinë nuk do të kishte kuptim të stërzgjatë. Meqë ky vend nuk e ka njohur Kosovë mirëpo, pse duhet të merremi më tej me Sllovinë? Ndryshimet e fundit që kanë ndodhur në hierarkinë e lartë të Bashkimit Evropian, në fakt ardhja e strukturave të reja qeverisëse në Bruksel, ka sjellë

një atmosferë politike kontradiktore lidhur me Kosovën. Ndonëse nuk po flasim për një "Bolton" evropian, disa nga këto figura me kompetenca të larta brenda hierarkisë qeverisëse të BE-së, vijnë nga "pesëshi" i shteteve evropiane që nuk e kanë njohur Kosovën. Ndër më kryesorët, është spanjoli Josep Borell, përfaqësues i lartë për politikë të jashtme të BE-së. Tjetri është sllovaku Miroslav Lajçak, i cili është emëruar s'i i ngarkuar i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi (3 prill 2020).

Me kaq nuk mbaron rrëfimi: Thomas Szunyogun është emëruar shef i ri i Zyrës së Bashkimit Evropian në Prishtinë. Vendi prej nga vjen Szunyogun është Çekia. Por, a mbaron këtu "rrëfimi"? Jo. Pse vallë?

Çështja se kush zgjidhet në hierarkinë më të lartë udhëheqëse të Bashkimit Evropian s'do të duhej të ishte shqetësimi ynë. Aq më pak kur ne as nuk jemi pjesë e BE-së. Veçse një duzinë figurash aktuale të BE-së, gjithandej na krijojnë dilema me qëndrimet e tyre "pro et contra" relacioneve Kosovë - Serbi. Mendoj, pa të keq, se që të tri figurat që i përmenda më lart, meqë do të jenë të përfshira në procesin e dialogut Prishtinë - Beograd, që besohet se do të zhvillohet këtë vit, në një apo tjetër dimension na shkaktojnë dilema, madje edhe dyshime lidhur me përfaqësimet dhe përgjegjësitë e tyre. Pse?

Po t'iu referohemi biografive të Lajçakut dhe Szunyogut, kuptojmë se ata janë njohës të mirë të relacioneve ballkanike dhe evropiane, janë figura të sprovuara në politikë dhe diplomaci dhe tejet komplementarë për kompetencat me të cilat janë ngarkuar nga BE-ja. Mirëpo, ritmi i zhvillimeve dhe ngjarjeve të fundit për dhe

rreth Kosovës, na shtyn të jemi paksa të shqetësuar për faktin nëse Lajçak dhe Szunyog, do të jenë konsekuentë në procesin e dialogut Prishtinë - Beograd. Pra, a do të jenë Lajçak dhe Szunyog parimorë dhe konsistentë në suaza të qëndrimeve të tyre politike dhe diplomatike? Me një fjalë, a do ta mbrojnë ata realitetin e krijuar në Kosovë: pavarësinë e shpallur të Kosovës dhe verdiktin e GJND-së kundrejt aktit të pavarësisë të realizuar në Prishtinë, më 17 shkurt 2008?

Kushedi, por ka diçka që na nxitë sërish që t'i referohemi titullit të këtij shkrimi: përgatitja arsimore dhe shkencore e Lajçakut dhe e Szunyogut. Të dy këta kanë qenë doktorantë në "Moscow State Institute of International Relations", pranë Universitetit "Komenski" të Moskës. Çuditërisht, Lajçaku dhe Szunyog kanë një të kaluar të përbashkët (ekskluzive) profesionale dhe shkencore. Por, a mund të kenë ata edhe ndonjë të kaluar tjetër "të përbashkët"...

As kjo çështje s'do të duhej të ishte preokupimi ynë, ndonëse si "pyetje a teze", mund ta shtrojmë për analizë më të gjerë dhe debat. Në anën tjetër, ndonëse kemi përpara një bazë solide për ndërtimin e një narracioni të cilin nuk kemi shumë nevojë që ta imagjinojmë, shpresojmë se Lajçaku dhe Szunyog nuk do të ulen në tavolinën e dialogut Prishtinë - Beograd për të zbatuar një mision politik dhe diplomatik të BE-së që do t'i pëlqente Serbisë, me insistentimin dhe përkrahjen e Ruisë!

Ngjashmëritë të historive kontradiktore dhe tragjike duhet dhënë fund. Muzgu i tyre duhet të largohet përfundimisht nga kontinenti ynë...

## Komuna e Drenasit radhitet në vendin e parë për sinjalistikë nga Autoriteti i Hekurudhave

DRENAS, 18 TETOR (ER) - Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, përkatësisht Departamenti i Sigurisë Hekurudhore, ka shpallur Komunën e Drenasit me performancë më të mirë sa i përket sigurisë për sinjalistikë. "Komuna e Drenasit ka kryer sinjalizimin e vendkalimeve hekurudhore, duke i pajisur me shenjat e sinjalizimit siç

janë shenjat stop, kryqi i andeut, shenja për praninë e binarëve, shenja për praninë e trenit etj. Këto të gjetura janë shënuar edhe në këtë raport", bëhet me dije në njoftimin e Komunës së Drenasit.

Vendosja e këtyre shenjave tregon përgjegjësinë e komunës sa i përket sigurisë në vendkalimet hekurudhore, të cilën e ka evidentuar edhe

Autoriteti i Hekurudhave, duke e radhitur Drenasin me performancë më të mirë të nivelit të sigurisë për sinjalistikë. Me këtë rast, drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapa, ka theksuar do të vazhdojnë të punojnë për ofrimin e shërbimeve më të mira për sigurinë e udhëtarëve dhe transportit të mallrave.





# 'Javët e Kulturës Shqiptare' në Austri s'i ndal as pandemia

"Javët e Kulturës Shqiptare" janë ngjarjet më të rëndësishme kulturore, artistike dhe sportive të komunitetit shqiptarë në Austri. Ato tashmë kanë krijuar emër, traditë, janë bërë institucion në vete, jo vetëm për aktivitetet e llojllojshme por, edhe si vendtakim, bashkim dhe përafrim me njëri-tjetrin.

Edhe pse në kohë pandemie, "Javët e Kulturës Shqiptare në Austri 20-21" edhe këtë vit do të organizohen. Për të shtatin vit më radhë këto aktivitete mbajnë vullën e organizimit të Këshillit Koordinues i Shoqatave Shqiptare në Austri. Me moton "Bukë, kripë e zemër", "Javët e Kulturës", vijnë para publikut shqiptarë dhe austriakë për të treguar traditën, bujarinë, mikpritjen dhe zemërgjerësinë e popullit tonë. "Planin për organizimin e "Javëve të Kulturës" e kishim mbaruar para pandemisë. Gjithçka tjetër ishte shumë sfiduese, duke filluar që nga pasiguria se a do të lejohen të mbahen aktivitetet. Situata më e komplikuar ishte nga fakti se sallat do duhej rezervuar. Megjithatë, momenti i relaksimit erdhi kur ne si "Këshillë Koordinues i Shoqatave", vendosëm që mos të konkretizojmë asgjë deri një muaj para eventeve", tha Kaltrina Durmishi, kryetare e KKSHSHA-së. Të merret iniciativë për të organizuar të gjitha këto aktivitete në këtë kohë të pakohë, natyrisht që nuk ishte edhe aq e lehtë. "Të marrësh vendime, duhet të

kesh guxim. Kur ke guximin, tejkalohej gjithçka. Ne e kishim guximin dhe vendimi për të organizuar nuk ka qenë i vështirë. Pjesa më e vështirë ndoshta kanë qenë konsultimet më të gjithë anëtarët dhe shoqatat bashkëpunuese, ngase kishte mendime të ndryshme. "Javët e Kulturës" janë bërë institucion në vete dhe do të ishte e dhimbshme nëse kishim qenë të detyruar për t'i anuluar këto aktivitete", thekson Kaltrina për Albinfo Austria.

## Në fokus të aktiviteteve do të jenë tri data kryesore

Ndryshe nga vitet e tjera, këtë vit "Javët e Kulturës" do të fillojnë nga muaji tetor dhe do të përfundojnë në muajin shkurt. "Këtë vit kemi menduar që përveç aktiviteteve tjera, në fokus t'i kemi tri data kryesore. Për nder të shtetit mik, Austrisë, do të fillojmë me 26 tetor, në Ditën e Pavarësisë së Austrisë, për të vazhduar me 28 Nëntor dhe për t'i përfunduar aktivitetet me 17 Shkurt, ditën e Pavarësisë së Kosovës", shpjegon Kaltrina. Një nga aktivitetet kryesore që edhe do të bëj hapjen e "Javëve të

**Koordinationsrat**

**Javët e Kulturës Shqiptare**

Projekti "Javët e Kulturës Shqiptare në Austri" është shumë i rëndësishëm për komunitetin shqiptar në Austri. Ky projekt është përmbljedhja e aktiviteteve vjetore që organizojnë shoqatat anëtare, dëshmi e përkushtimit për përcjellimin e kulturës shqiptare dhe njëkohësisht integrimin të pjesëtarëve të komunitetit tonë në shoqërinë shumicë austriake.

**Këshilli Koordinues i Shoqatave Shqiptare në Austri**

Këshilli Koordinues i Shoqatave Shqiptare në Austri është një shoqatë që ka për qëllim të koordinojë aktivitetet e shoqatave ekzistuese shqiptare në Austri dhe të organizojë vet aktivitetet në interes të komunitetit shqiptar për të cilat nuk ekzistojnë struktura organizuese.

**Bukë, kripë dhe**

**2020**

- 18 TETOR: Gare Ndërkombëtare shahu Liga e Shahut "Arbëria"
- 23 TETOR: Prezantim libri "Pranvera e helmuar Lidhja e shkrimtarëve "Alexander Moisiu"
- 26 TETOR: Koncert/Performance "Classic meets Ethno" Këshilli Koordinues
- 02 NENTOR: Filmi "Dita ze hill" Këshilli Koordinues & Fjorda Ukmani
- 13 NENTOR: Ka ney me Harababura Mare Organizata Ka
- 21 NENTOR: Feste për Pavarësinë e Shqiperise Panair me veshje kombëtare "17 Shkurti" & Këshilli Koordinues
- 22 NENTOR: Orë letrare Lidhja e shkrimtarëve "Alexander Moisiu"
- 28 NENTOR: Shtaqja letrare "Pesë stinët e armikut të popullit" Këshilli Koordinues & Alban Beqiraj
- 29 NENTOR: Feste për Pavarësinë e Shqiperise Shoqata "Iliria"
- 29 NENTOR: Turneu i Lijes Liga Shqiptare e Futbollit

**2021**

- 13 SHKURT: Feste për Pavarësinë e Kosovës Shoqata "17 Shkurti"
- 15 SHKURT: Orë letrare Lidhja e shkrimtarëve "Alexander Moisiu"
- 21 SHKURT: Ka ecje në natyrë Organizata Ka
- 22-27 SHKURT: Panair për Pavarësinë e Kosovës Këshilli Koordinues

**Bundesministerium Europäische und internationale Angelegenheiten** **Bundesministerium Kunst, Kultur, öffentlicher Dienst und Sport** **Stadt Wien** **Stadt Wien** **EUROPA HAUS WIEN**

## Programi i Javëve të Kulturës në Austri

Kulturës" do të jetë koncerti "Classic meets Ethno" me 26 tetor i cili do të gërshetohet muzikën klasike dhe atë etno. "Fati jonë i mirë është se në Austri kemi një numër të madh artistësh të cilët kanë krijuar emër në botën e artit. Ky koncert do t'i bëj bashkë të gjithë ata për të na sjell një mbrëmje të paharrueshme për audiencën shqiptare dhe miqtë austriakë e ndërkombëtarë. Në këtë koncert do të përformojnë: Flaka Goranci, mezzosoprano,

Eno Peçi koreograf dhe balerinë, Rina Kaçinari, Zaimir Kabo në piano dhe me violinë, Aurel Qirjo i cili do të vijë enkas nga Londra", shprehet Kaltrina duke shtuar se ky koncert ka zgjuar interesim shumë të madh për pjesëmarrje të komuniteti tonë në Austri. Për gjatë katër muajsh, do të këtë aktivitete të llojllojshme: si koncert klasik i gërshetuar me etno, turnir shahu, turnir futbollit, promovim libri, orë letrare, koncerte muzikore me

këngë dhe valle shqiptare, mbrëmje rinore, shfaqje filmi, një panair shqiptarë ku do të përfshihen: punime dore, veshje kombëtare, promovim i produkteve shqiptare që janë në Austri, ecje në natyrë, e shumë të tjera. Për shkak të ndryshimeve të masave nga dita në ditë që po merren nga qeveritë shtetërore, ekziston një drojë se ndonjë nga aktivitetet edhe mund të anulohet. "Frikën më të madhe e kemi për aktivitetet që do zhvillohen në muajin nëntor. Ka shumë spekulime që mund të këtë një mbyllje të lehtë, ndonëse ende as qeveria austriake nuk ka dhënë detaje. Deri më tani në nëntor është në pyetje vetëm eventet nga Shoqëria Kulturore Artistike "17 Shkurti" e cila zakonisht ka mbledhur deri në 1500 veta. Zotëri Tahir Turkaj ka më shumë se 25 vjet që asnjëherë nuk e ka humbur organizimin e manifestimit të festës së "28 Nëntorit". Megjithatë, duhet të jemi të gjithë të kujdesshëm, të ruajmë shëndetin tonë duke mbajtur distancën dhe maskat dhe të respektojmë rregullat e institucioneve shtetërore austriake. Nuk dëshirojmë asnjë i infektuar të dalë në aktivitetet tona", tha kryetarja Durmishi. "Javët e Kulturës Shqiptare në Austri" këtë vit janë përkrahur kryesisht nga institucionet austriake. Poashtu gatishmëri për të mbështetur këto aktivitete kanë premtuar edhe Rrjeti i Bizneseve Shqiptarë në Austri dhe disa kompani të tjera shqiptare. / albinfo /

# Panairi i Librit në Shqipëri do të zhvillohet online për shkak të Covidit-19

Pas njoftimit nga Ministria e Shëndetësisë së Shqipërisë se për shkak të pandemisë Panairi i Librit për këtë vit nuk do të zhvillohet, ka reaguar edhe Shoqata e Botuesve Shqiptarë. Në një postim në Facebook, Shoqata e Botuesve Shqiptarë ka bërë të ditur se Panairi i Librit do të zhvillohet online. Postimi i plotë është si më poshtë:

## “Njoftim për organizimin online të Panairit të 23 të Librit – Tirana 2020

Sot u zhvillua mbledhja e zgjeruar e kryesisë së Shoqatës së Botuesve Shqiptarë, me temë: Organizimi online i Panairit të 23 të Librit të Tiranës, në kushtet e pandemisë Covid-19. Të bindur që Panairi i Librit është një ngjarje madhore, e cila nuk

duhet t'i mungojë qytetit të Tiranës, por edhe lexuesve nga gjithë vendi, të gjithë të pranishmit ishin të një mendjeje për organizimin, në ditët e caktuara që më parë, të një panairi libri, kësaj here në një edicion special, kryesisht online, për shkak të pandemisë. Ky panair do të karakterizohet nga një bashkëpunim i gjerë i botuesve shqiptarë. Gjatë ditëve të tij, botues, shkrimtarë, poetë, përkthyes, lexues dhe njerëz të kulturës do të takohen për diskutime librash, prezantime titujsh të rinj, por edhe tryeza debatesh, në live stream, ose në mjedise fizike, duke respektuar të gjitha kushtet e sigurisë. Që sot ka filluar puna për organizimin e Panairit të Librit Online. Qendra e këtyre veprimtarive do të jetë qyteti i Tiranës që këtë vit ka 100-vjetorin e tij” (sic.)



## Pavdekësia do të ishte ndëshkimi më i keq




Nga: Jorge Luis Borges Përktheu: Bajram Karaballi Kur ndihem i fatkeq mendoj për vdekjen. Të vetmin ngushëllim që kam është: të di se nuk do të vazhdoj të jem më, të mendoj se do të ndaloj së qeni. Kjo do të thotë: unë ndihem

i sigurt përtej disa tmerreve të natyrës fetare, përtej krishterimit, që natyrisht e kam në gjakun tim... përtej gjithë kësaj, unë jam i sigurt se do të vdes plotësisht. Dhe është një ngushëllim i madh. Është diçka që i jep shumë forcë

një njeriu, kur e kupton se është i përkohshëm. Përkundrazi, ideja për të qenë i përhershëm më duket se është një ide vërtet e tmerrshme. Pavdekësia do të ishte ndëshkimi më i keq.

Çdo formë pavdekësie do të ishte ferr. Parajsja, nëse do të zgjaste shumë, do të ishte gjithashtu ferr. Çdo gjendje e qëndrueshme është një kob. Ndoshta një nga virtetet më të mëdha të jetës është që gjithçka

është e përkohshme, madje edhe vetë fiziku ynë është i tillë, kënaqësia është gjithashtu kalimtare, dhe është mirë që është e tillë, sepse përndryshe gjithçka do të ishte shumë e mërzitshme.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

# Drita ndalet në barazim nga Gjilani

Skuadra e Dritës e ka regjistruar barazimin e parë në këtë kampionat, pasi ndau pikët në derbin me rivalin lokal, Gjilani. Trajneri nga Shqipëria, Klodian Duro, ka debutuar me barazim në krye të shtabit teknik të Feronikelit. Ky i fundit ndau pikët me Trepçën '89



**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 18 TETOR** - Derbi më i madh në futbollin e Kosovës në mes të Dritës dhe Gjilanit përfundoi baras 0-0. Skuadra kampione ishte dominuese në këtë ndeshje, por assesi nuk arriti të gjejë rrugën e golit që do t'ia siguronte fitoren e katërt. "Nuk më mërziit aspak fakti që nuk fituam, pasi që luajtëm mirë. Kemi krijuar shumë raste, dominuam gjithë ndeshjen, sikurse në pjesën e parë, po ashtu edhe në pjesën e dytë. Kur ekipi luan mirë, rezultati do të vijë patjetër. Përballë vetes kishim një kundërshtar mjaft të fortë. Mundësitë nuk i shfrytëzuam për ta fituar ndeshjen, por mbetëm i kënaqur me atë se çfarë treguan futbollistët në këtë ndeshje", ka thënë pas ndeshjes Ardian Nuhiu, trajner i Dritës.

Rastin e parë në ndeshje e pati, pas pesëmbëdhjetë minutave lojë, Kastriot Rexha, por goditja e tij u bllokua nga kapiteni i Gjilanit, Ylber Kastrati. Në minutën e 30-të Xhevdet Shabani tentoi nga gjuajtja e lirë, mirëpo në vend ishte portieri Koliçi. Ky i fundit, pas katër minutave, ndali edhe gjuajtjen e Ilir Blakçorrit. Në pjesën e dytë, Gjilani më shumë u mundua nëpërmjet kundërsulmeve ta rrezikojë portën kundërshtare, derisa Drita pati një rast të mirë, por Festim Alidema gjuajti plogësht dhe rezultati mbeti i pandryshuar. "E nisëm ndeshjen mirë, por më pas filluam të lëshonim terren, me ç'rast edhe skuadra e Dritës na vuri në vështirësi për disa momente. Në pjesën e dytë u shfaqëm krejtësisht ndryshe, me ç'rast dominuam ndaj kundërshtarit në

fushën e lojës. Tentuam të mbanim topin sa më gjatë në posedim dhe të krijonim mundësi, por gjithsesi mbetëm i kënaqur me reagimin e skuadrës në pjesën e dytë dhe kjo ka rëndësi. Në derbi natyrisht se ka shumë duele, pasi që dy skuadrat luajnë për të fituar. Ne ishim të përgatitur edhe për duele, pasi që kemi futbollistë me përvojën e derbit dhe e dinë mënyrën se di duhet t'i qasen kësaj ndeshje", ka thënë trajneri i Gjilanit, Gentian Mezani.

Trajneri nga Shqipëria, Klodian Duro, ka debutuar me barazim në krye të skuadrës së Feronikelit, pasi skuadra nga Drenasi ndau pikët me Trepçën '89. Të dyja skuadrat kishin raste shënimi, por assesi nuk arritën të shënojnë. Duro e zëvendësoi në shtabin teknik te Feronikelit, Afrim Tovërlanin. Pas gjashtë ndeshjeve Trepça '89 është e shtata me shtatë pikë, kurse "Nikli" është një pozitë me poshtë me gjashtë pikë. Të shtunën fitores i është gëzuar Prishtina në përballje me Besën e Pejës (4-0). Lojtari kryesor në këtë ndeshje për skuadrën kryeqytetase ishte Otto John, i cili shënoi tre gola (3', 25' e 59'), derisa me një gol kontribuo i Mërgim Pefqeli (75'). Ndërkohë, në ndeshjen që u zhvillua në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë, Drenica arriti që ta befasojë skuadrën e Llapit, duke mposhtur me rezultat minimal 0-1. Pjesa e parë e ndeshjes u mbyll 0-0, kurse nëntë minuta pasi filloi pjesa e dytë, Hysen Tahiri realizoi golin e fitores për rezultatin final 0-1. Drenica pas gjashtë ndeshjeve ka grumbulluar tetë pikë, kurse Llapi mbetet me vetëm një pikë të grumbulluar nga pesë ndeshje të zhvilluara.

## SUPERLIGA

Drita - Gjilani	0-0
Trepça '89 - Feronikeli	0-0
Llapi - Drenica	0-1
Prishtina - Besa	4-0
Arbëria - Ballkani	2-4

## TABELA

1. Ballkani	6 16 pikë
2. Drita	4 10
3. Gjilani	6 9
4. Prishtina	5 8
5. Arbëria	6 8
6. Drenica	6 8
7. Trepça '89	6 7
8. Feronikeli	6 6
9. Besa	6 3
10. Llapi	5 1

Në xhiron e radhës takohen: Besa-Llapi, Drenica-Arbëria, Feronikeli-Prishtina, Ballkani-Drita, Gjilani-Trepça '89.

## LIGA E PARË

### GRUPI A

Vëllaznimi - Liria	1-0
Trepça - Dukagjini	3-2
Onix - A&N	1-0
Drenasi - Vushtrria	1-0
Malisheva - Istogu	3-1

### GRUPI B

Dardana - Flamurtari	0-0
Ferizaj - Ramiz Sadiku	1-1
KEK-u - 2 Korriku	3-2
Vitia - Kika	1-0
Ulpiana-Vllaznia	1-0

## SHKURT

### Trepça mbetet në Superligë

KB Trepça ka shënuar fitore bindëse ndaj AS Prishtinës në sfidën e dytë të "play-out"-it me rezultat 115:47 (33:8, 27:9, 19:11, 36:9). Në takimin e parë të zhvilluar në Prishtinë, mysafirët nga Mitrovica kishin fituar me rezultat 54:76 dhe kështu "Xehetarët" do të garojnë edhe në edicionin e ardhshëm në elitën e basketbollit të Kosovës. Vendasit e nisën mirë duke e fituar çerekun e parë 33:8, derisa lojë të mirë vazhduan edhe në periodën e dytë, që e fituan 27:9. Edhe në pjesën e dytë nuk kishte ndryshime, me Trepçën që fiton periudhën e tretë 19:11 dhe atë të fundit 33:9 për të triumfuar në fund me rezultat bindës 115:47. Te Trepça u dalluan Mojeed Ewuosho me 24 pikë e 6 kërcime dhe Devin Haygood me 19 pikë e 9 kërcime, kurse te AS Prishtina më të mirët ishin Dardan Sejdiu me 16 pikë e 14 kërcime dhe Don Polloshka me 21 pikë.

### Rashica në janar i bashkohet Leverkusenit

Ylli i skuadrës Werder Bremen, Milot Rashica, do të transferohet në Bayer Leverkusen gjatë muajit janar të vitit të ardhshëm. Futbollisti 24-vjeçar tashmë ka rënë dakord për një marrëveshje pesëvjeçare me Leverkusenin. Anëtori i kosovar do të luajë për skuadrën në fjalë në fillim të vitit 2021.

### Zogaj do ta ndajë drejtësinë në ndeshjen Barcelona - Ferencvaros

Barcelona për testin e radhës zbrit në 'Camp Nou', në kuadër të grupit G në Ligën e Kampionëve përballet me Ferencvaros. Ndeshja do të luhet të martën, me fillim nga ora 21:00. Në këtë ndeshje, një nga gjyqtarët do të jetë nga Kosova. Bëhet fjalë për Bekim Zogaj, i cili do të jetë asistenti i Sandro Scharer. Kjo është hera e parë që një gjyqtar nga Kosova ndan drejtësinë në një ndeshje të skuadrës së Barcelonës.

### Behrami: Kisha frikë, përjetova ditë të vështira

Mesfushori i Genoas, Valon Behrami, ka thënë se druhej për shëndetin e vet dhe se kishte frikë se do t'i infektonte të afërmit me koronavirus, pasi ishte infektuar me Covid-19. "Miliona njerëz janë prekur nga ky virus, mbi 36 mijë persona kanë vdekur në Itali nga ky virus. Nuk duhet të na bëjnë të ndihemi fajtorë që e kemi marrë virusin, sepse puna jonë na kërkon të udhëtojmë dhe është sport kontakti, prandaj mund të na ndodhë secilit", ka thënë Behrami. "Përjetuam ditë të vështira dhe, derisa jam mësuar të riaftësohem fizikisht pas lëndimeve, mendërisht kjo ka qenë një përvojë krejt ndryshe. Kisha frikë. Frikësohesh për shëndetin tim, se mos po i infektuam më të dashurit e mi, sepse në atë moment futbollin nuk është shqetësimi yt i parë. Me virus nuk je lojtar i sëmurë, por njeri i cili ndihet i brishtë", ka deklaruar Behrami.

## KB Prishtina prezanton skuadrën për sezonin e ri

PRISHTINË, 18 TETOR - KB Prishtina ka prezantuar skuadrën për sezonin 2020/21. Titulli i kampionit do të jetë synimi për skuadrën kryeqytetase, e cila këtë edicion do të paraqitet me shumë emra të rinj.

Trajneri Andin Rashica nuk do të ketë shumë lojtarë nga garda e vjetër, me Edmond Azemin dhe Fisnik Rugovën si dy lojtarë që nuk janë dorëzuar ende. Meriton Ismaili, Muhamedali

Janjeva dhe emra të tjerë do të jenë ata që do ta shkruajnë kapitullin e ri për këtë skuadër. Lista e basketbollistëve: Kapiten - Edmond Azemi (kapiten), Atik Koshi, Altin Morina, Arian Memeti, Fisnik

Rugova, Mërgim Jakupi, Dion Haxhosaj, Arbër Sinani, Meriton Ismaili, Muhamedali Janjeva, Eliot Peci, Albin Rexhepi, Don Polloshka, Arian Qallaku, Bledar Thaçi, trajner Adin Rashica.



## Istogu kalon në raundin e tretë të Kupës Evropiane

ISTOG, 18 TETOR - KHF Istogu ka kaluar në raundin e tretë të Kupës Evropiane në konkurrencë të femrave. Istogu në raundin e dytë e ka kaluar Vushtrrinë me dy fitore bindëse. Ishte hera e parë që dy skuadra të Kosovës u takuan në kuadër të garave evropiane. Për Istogun të shtunën mbrëma kishte festë të dyfishtë. Pos që kaloi në raundin e tretë, KHF Istogu për herë të parë luajti në palestrën në Istog. Me ndeshjen e së shtunës ndaj Vushtrrisë është përfunduar palestra në Istog që do t'i japë hov zhvillimit të hendbollit në këtë komunë. Istogu e fitoi ndeshjen e kthimit me rezultat bindës, 31:24. Pas pjesës së parë rezultati ishte 17:13. Ndërkohë ndeshjen e parë të luajtur para një jave në Samadrexhë, Istogu e kishte fituar me rezultat 26:21. Me dy fitore të thella KHF Istogu kalon në raundin e tretë ku do të garojë edhe kampioni i Kosovës, Ferizaj. Ferizaj garimin e nis prej raundit të tretë. Për herë të parë



do t'i kemi dy skuadra në raundin e tretë. Ndeshjen në Istog e kanë dominuar vendaset që herët nisën shkëputjen në rezultat. Epërsia e istogaseve ishte bindëse gjatë tërë ndeshjes, ndërsa rastet i fituan të gjitha lojtaret.

### ISTOGU - VUSHTRRIA 31:24 (17:13)

Istogu: Muratoviq 10, Rugova 9, Venetski 4, Ujkiq 3, Hetemi 2, Fejzaj 1, Shatri 1, Berisha 1, Ferataj, Rexhaj, Halitaj, Milatoviq, Ahmetxhekaj, Shehdadi.  
Vushtrria: Rama 9, Zymeri 5, Kasumi 4, Sopjani 3, Tahiri 2, Matarova 1, Paci, Avdiu, Preniqi, R. Gubetini, Terstena, Kelmendi, B. Gubetini, Rrustemi.

## Ronaldo bllokoi transferimin e Messit në Juventus

TORINO, 18 TETOR - Leo Messi ishte afër largimit nga Barcelona dhe shumë klube u gëzuan nga ky lajm. Manchester City, PSG-ja dhe Juventusit përparësitë ofertat e tyre, por situata mes kapitenit argjentinas dhe drejtuesve të klubit katalanas u tensionua shumë. Këta të fundit nuk e mbajtën fjalën dhe "pleshti" zgjodhi të qëndronte edhe një vit në "Camp Nou", teksa do të largohet në fund të këtij sezoni si lojtar i lirë. Juventusit kishte gati një ofertë tunduere për Barcelonën, por gjithçka u bllokua nga Cristiano Ronaldo. Emra si Dybala, De Ligt dhe Alex Sandro do të përfshiheshin në operacionin e blerjes së Messit.



"Diariogol.com" raporton se Ronaldo nuk e donte yllin argjentinas si shok skuadre. Negociatat u ndërpre, drejtuesit e kampionëve të Italisë

respektuan dëshirën e portugezit, duke humbur në këtë mënyrë një rast unik për të parë në një ekip dy legjenda të lojës me top.

### SHKURT

#### Koeman: Në janar e dua Depayn

Trajneri i Barcelonës, Ronald Koeman, nuk i ka humbur shpresat për të marrë Memphis Depayn. Klubi katalanas në verë dështoi që ta transferojë sulmuesin holandez, por pritet që në janar të bëjë një ofertë të re. "Është sigurisht një mundësi. Do ta provoj, sepse dua ta kem te Barcelona. Por nuk mund ta di tani situatën financiare në të cilën do të ndodhet klubi në janar. Të presim dhe të shohim", ka thënë Koeman. "Ishte gjithçka gati, por për shkak të rregullave të La Ligas e dinim se duhej të shisnim më parë një futbollist. Në fund nuk ka ndodhur. Donim Memphis sepse ka cilësi që, sipas meje, mungojnë. Pjesa më e madhe e sulmuesve tanë e duan topin në këmbë, Depay di të luajë në thellësi", ka deklaruar Koeman.

#### Ibra: Ende jam i pandalshëm

Zlatan Ibrahimoviçi është mbushur plot motivim pas ndeshjes ndaj Interit. Ylli suedez ishte ai që i dha vulën 'Derby della Madonnina', me dy golat e shënuara. "Nëse do të kisha nivelin e përgatitjes që kisha 10 vjet më parë, askush nuk do të mund të më ndalte. Më falni, pasi ata as tani nuk mund të më ndalin", ka thënë Ibra fillimisht. Ibrahimoviçi regjistroi një penallti të humbur, por atë e konkretizonte menjëherë në gol, për të shtuar edhe një top në rrjetë me ndihmën e asistimit të Rafael Leao.

#### Zidane i zhgënjyer pas humbjes së parë në La Liga

Real Madridi ka pësuar humbjen e parë këtë edicion në La Liga duke u mposhtur nga Cadizi me rezultat minimal 0-1. Pas kësaj disfatë, i zhgënjyer është shprehur trajneri Zinedine Zidane, i cili ka kritikuar ashpër qëndrimin e skuadrës në fushë. "Ata kishin më shumë ritëm dhe dëshirë. Ne nuk duhet të shtiremi për këtë humbje, ishte lojë e keqe nga ana jonë. Duhet ta urojmë Cadizin. Nuk jemi të lumtur, por kjo mund të ndodhë në futboll", ka thënë Zidane. "Ne hasëm në vështirësi që nga fillimi i ndeshjes dhe nuk do të isha befasuar sikur të prananim edhe dy apo tre gola në pjesën e parë. Nuk duhet të kërkojmë falje për këtë. Kjo nuk do të ndikojë në rrugën tonë përpara. Ishte natë e keqe, por do ta kalojmë", ka shtuar Zidane.

#### Pensionohet Zabaleta

Ish-mbrojtësi i Manchester Cityt dhe West Hamit, Pablo Zabaleta, ka njoftuar tërheqjen nga futbollit. Argjentinasit u transferua në "Etihad" nga Espanyoli më 2008 dhe luajti 333 ndeshje për "Qytetarët" duke fituar dy tituj kampionë. 35-vjeçari luajti edhe 58 ndeshje me kombëtaren e Argjentinës, por pa arritur të fitojë ndonjë trofe me kombëtaren. "Pas 18 vjetësh si futbollist profesionist, mora vendimin për ta lënë futbollin. Këto kanë qenë vite të mrekullueshme që më kanë dhënë mundësinë që të shijoj momente unike dhe të paharrueshme. Do t'i falënderoj të gjithë njerëzit që e nisën udhëtimin me mua: klubet, shokët e skuadrës, trajnerët, në veçanti familjen dhe të gjithë miqtë e mi", ka shkruar Zabaleta në "Twitter".

## Lopezi fiton titujt WBA dhe WBO

Teomo Lopez Jr. ka marrë një fitore befasuese me vendim unanimit kundër Vasiliy Lomachenko duke marrë titujt WBA, WBC dhe WBO të peshave të lehta dhe duke ia shtuar titullit të tij IBF të shtunën në mbrëmje. Vendimi i gjyqtarëve në MGM Grand në Las Vegas ka qenë 116-112, 119-109 dhe 117-111, të gjithë në favor të 23-vjeçarit Lopez, i cili është bërë

boksieri më i ri me katër tituj në historinë e boksit. Lopezi (16-0, 12 KO) ka shtangur botën e boksit pa pasur nevojë për të përdorur një fuqi të madhe. Ai ka lënë në hije Lomachenkon

(14-2 10 KO) i cili është paraqitur në këtë ndeshje si boksieri më i mirë në qarkullim. Ukrainasi është zgjuar vonë dhe Lopezi ka pasur një shpërthim në raundin e 12-të

për ta siguruar fitoren. Ai ka sulmuar Loman në trup, siç ka bërë për pjesën e parë të ndeshjes, dhe e ka dëmtuar Lomachenkon me një të djathtë të fortë.

për ta siguruar fitoren. Ai ka sulmuar Loman në trup, siç ka bërë për pjesën e parë të ndeshjes, dhe e ka dëmtuar Lomachenkon me një të djathtë të fortë.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrypa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553  
PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.





ROYAL CROWN



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

